



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.192/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Laziq dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partija e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Partija Demokratike e Ashkalinjëve (PDAK), dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.192/2017 e datës 10.06.2017 ankesa e parashtruar subjekti politik Partija e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

A r s y e t i m

Me datën 10.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partija e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, në të cilin pretendohet se kryetari i PDAK-së dhe kandidat për deputet në këtë subjekt politik, Danush Ademi më datën 09.06.2017 në ora 24:00 nga llogaria e tij personale në facebook ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë i cili ka bërë thirrje për votim.

Parashtruesi i ankesës, parregullsisë së evidentuar i ka bashkangjitur si dëshmi një kopje të postimit.

Në përgjigjen në ankesës të datës 11.06.2017, subjekti politik PDAK thekson se ankesa e bërë nga subjekti PAI është ankesë e pabazë dhe nuk është e vërtetë se kanë bërë fushatë më datën 10.06.2017. Fotot që ju kanë bashkangjitur ankesës i kanë rregulluar me fotoshop sepse postimi në facebook është bërë me datën 09.06.2017 në ora 18:46 dhe përmbyllaj e fushatës është bërë prej orës 21:00 me të cilën ka qenë e lajmruar KQZ dhe Policia. Andaj ka kërkuar nga PZAP-i që ankesa e parashtruar të refuzohet. Përgjigjes në ankesë ju ka bashkangjitur foton që është postuar me datën 09.06.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar se shkelësi i supozuar e ka vazhduar të bëjë thyerjen e heshtjes zgjedhore nëpërmjet Facebook. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar pas përmbylljes së fushatës zgjedhore sepse nuk përmban as datën dhe as orën për publikim.

Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar ngase nga provat e ofruara si dëshmi nuk është arritur që të vërtetohet shkelja e pretenduar në ankesë e cila do të vërtetonte pretendimet ankimore, andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.192/2017 më datën 12.06.2017



Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.